Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
Association of Journalists of Kosovo

Raporti i Monitorimit të Medias dhe Gjuhës së Urrejtjes

March - May 2026

Autori:
Jeton Mehmeti
Hulumtues:
Marigona Berisha

Monitorimi i gjuhës së urrejtjes, dezinformimit dhe diskursit polarizues në transmetimet elektronike, lajmet online dhe mediat sociale në mediat në gjuhën shqipe dhe serbe

Dokumenti u zhvillua në kuadër të projektit 'Forcimi i Lirisë së Medias, Bashkëpunimit Ndëretnik dhe Luftimit të Gjuhës së Urrejtjes në Kosovë', i zbatuar nga Asociacioni i Gazetarëve në Kosovë me mbështetjen e UNMIK-ut. Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë vetëm ato të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK).

TABELA E PËRMBAJTJES

01 Përmbledhje Ekzekutive

02 Metodologjia dhe Këndi i Punës

03 Përmbledhje e Gjetjeve Kryesore

04 Analiza sipas Llojit të Medias

05 Shpërndarja sipas Nivelit të Përdorimit

06 Analiza e Folësve dhe Objektivave të Synuara

07 Kornizat Narrative dhe Toni Emocional

08 Raste studimore

09 Rekomandime

10 Shtojcat

Përmbledhje Ekzekutive

Ky raport paraqet gjetjet e një ushtrimi tremujor monitorimi mbi gjuhën e urrejtjes dhe diskursin e dëmshëm në mjedisin mediatik të Kosovës, i realizuar gjatë periudhës mars–maj 2026. Monitorimi përfshiu transmetimet televizive, portalet online të lajmeve, platformat e mediave sociale dhe burime të tjera publikisht të qasshme në gjuhën shqipe dhe serbe. Qëllimi i monitorimit ishte identifikimi, dokumentimi dhe analizimi i modeleve të gjuhës së urrejtjes dhe diskursit të dëmshëm, vlerësimi i shkallës së ashpërsisë së tyre, si dhe shqyrtimi i ndikimit që ato kanë mbi lirinë e medias, debatin demokratik dhe kohezionin shoqëror.

Gjatë monitorimit u identifikuan gjithsej 138 raste të gjuhës së urrejtjes dhe diskursit të dëmshëm. Megjithëse raporti fokusohet në gjuhën e urrejtjes, ai ndjek një qasje analitike më të gjerë sesa përkufizimi juridik i parashikuar në nenin 141 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Përveç formave potencialisht të kundërligjshme të gjuhës së urrejtjes, monitorimi shqyrtoi edhe retorikën armiqësore, delegjitimimin, demonizimin, stereotipizimin, narrativat konspirative, retorikën kundër gazetarëve dhe forma të tjera të komunikimit që mund të kontribuojnë në polarizim, diskriminim, armiqësi ose mosbesim.

Gjetjet tregojnë se diskursi i dëmshëm politik dhe ideologjik ishte kategoria më e përhapur, duke përbërë 99 nga 138 rastet e dokumentuara (71.7%). Ndryshe nga format tradicionale të gjuhës së urrejtjes, të cilat zakonisht synojnë grupe të cenueshme, kjo kategori karakterizohej kryesisht nga përplasje armiqësore ndërmjet aktorëve politikë dhe figurave publike, të cilët shpesh i paraqisnin kundërshtarët si tradhtarë, armiq, agjentë të huaj ose kërcënime ndaj interesave kombëtare. Armiqësia politike ishte veçanërisht e dukshme në debatet televizive të transmetuara në oraret kryesore (prime-time), ndërsa më pas amplifikohej përmes portaleve online të lajmeve dhe platformave të mediave sociale. Monitorimi konstatoi se polarizimi politik mbetet nxitësi kryesor i diskursit të dëmshëm në mjedisin mediatik bashkëkohor të Kosovës.

Analiza identifikoi gjithashtu dallime të rëndësishme ndërmjet mediave në gjuhën shqipe dhe atyre në gjuhën serbe. Nga numri i përgjithshëm i rasteve të dokumentuara, 107 raste buronin nga mediat në gjuhën shqipe (77.5%), ndërsa 31 raste nga mediat në gjuhën serbe (22.5%). Diskursi në gjuhën shqipe dominohej nga përplasjet politike dhe sulmet e personalizuara, ndërsa diskursi në gjuhën serbe përfshinte më shpesh narrativa të viktimizimit kolektiv, pasigurisë etnike dhe kërcënimeve të perceptuara ndaj komunitetit serb.

Përveç narrativave politike dhe etnike, monitorimi dokumentoi edhe raste të retorikës kundër gazetarëve, si dhe forma të diskursit të dëmshëm të bazuara në gjini dhe identitet. Ndonëse këto kategori ishin më pak të pranishme, ato nxjerrin në pah sfidat e vazhdueshme që lidhen me lirinë e medias, barazinë dhe përfshirjen shoqërore. Raporti evidenton gjithashtu një ndërthurje të konsiderueshme ndërmjet diskursit të dëmshëm, narrativave konspirative dhe amplifikimit digjital, ku mediat sociale luajnë një rol qendror në zgjerimin e shtrirjes dhe rritjen e dukshmërisë së përmbajtjeve nxitëse dhe polarizuese.

Analiza e ashpërsisë tregon se shumica e rasteve të dokumentuara përfshinin komunikim fyes, armiqësor ose delegjitimues, dhe jo nxitje të drejtpërdrejtë. Nga 138 rastet e regjistruara, 64 u klasifikuan në Nivelin 1, 40 në Nivelin 2 dhe 28 në Nivelin 3, ndërsa gjashtë raste u vlerësuan në nivelet më të larta të ashpërsisë (Nivelet 4 dhe 5). Megjithëse rastet më të rënda ishin relativisht të rralla, monitorimi tregon se retorika e dëmshme që përfshin demonizimin, përjashtimin dhe kërcënimet vazhdon të jetë e pranishme në mjedisin mediatik të Kosovës.

Përmbledhje Ekzekutive

Raporti arrin në përfundimin se sfida kryesore nuk qëndron te prania e përhapur e gjuhës së urrejtjes së shprehur qartë, sipas përkufizimit të së drejtës penale, por te normalizimi i formave armiqësore, stigmatizuese dhe delegjitimuese të komunikimit, të cilat kontribuojnë në polarizimin e shoqërisë dhe minojnë cilësinë e debatit publik. Gjetjet tregojnë më tej se ekosistemet digjitale mediatike shpesh e amplifikojnë këtë lloj diskursi, duke rritur dukshmërinë e tij dhe ndikimin në shoqëri.

Për t'iu përgjigjur këtyre sfidave, raporti rekomandon forcimin e standardeve profesionale të gazetarisë, përmirësimin e praktikave të moderimit dhe redaktimit, promovimin e komunikimit politik të përgjegjshëm, rritjen e monitorimit të diskursit të dëmshëm në mediat transmetuese dhe online, si dhe zgjerimin e iniciativave për edukimin mediatik dhe kundër-narrativat (counter-speech). Rekomandime të veçanta u drejtohen Komisionit të Pavarur të Mediave, Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës, organizatave mediatike, aktorëve politikë, organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve arsimore.

Në përgjithësi, raporti nënvizon rëndësinë e vazhdimit të monitorimit dhe të veprimit të koordinuar ndërmjet institucioneve dhe akterëve relevantë, me qëllim të krijimit të një mjedisi mediatik që mbështet dialogun demokratik, lirinë e medias, respektin e ndërsjellë dhe kohezionin shoqëror në Kosovë.

1. Hyrje

1.1 Konteksti

Gjuha e urrejtjes, narrativat e dëmshme dhe format e tjera të diskursit armiqësor janë bërë gjithnjë e më të dukshme në mjediset mediatike bashkëkohore. Ndërsa liria e shprehjes mbetet një vlerë themelore demokratike, komunikimi që promovon armiqësi, diskriminim ose urrejtje mund të minojë kohezionin shoqëror, debatin demokratik dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

Në Kosovë, një peizazh mediatik i larmishëm, i përbërë nga transmetues audiovizivë, portale online të lajmeve dhe platforma të mediave sociale, luan një rol të rëndësishëm në formësimin e opinionit publik dhe diskursit politik. Në të njëjtën kohë, polarizimi politik, ndjeshmëritë etnike, dezinformimi dhe rënia e besimit në institucione krijojnë kushte në të cilat narrativat e dëmshme mund të përhapen dhe të fitojnë dukshmëri.

Vitet e fundit janë shoqëruar me shqetësime në rritje lidhur me retorikën politike armiqësore, sulmet ndaj gazetarëve, polarizimin etnik, abuzimin e bazuar në gjini dhe përdorimin e dezinformimit për të forcuar narrativa përçarëse. Platformat e mediave sociale i kanë amplifikuar më tej këto sfida duke mundësuar shpërndarjen e shpejtë të përmbajtjeve nxitëse dhe polarizuese.

Për të kuptuar më mirë këto tendenca, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) realizoi këtë ushtrim monitorimi me qëllim dokumentimin dhe analizimin e gjuhës së urrejtjes dhe diskursit të dëmshëm në mjedisin mediatik të Kosovës. Gjetjet synojnë të mbështesin llogaridhënien mediatike, gazetarinë etike dhe diskutimet e informuara për politikat publike.

1.2 Objektivat e Ushtrimit të Monitorimit

Ky ushtrim monitorimi synoi të identifikojë, dokumentojë, klasifikojë dhe analizojë rastet e gjuhës së urrejtjes dhe diskursit të dëmshëm në peizazhin mediatik të Kosovës.

Në mënyrë më specifike, monitorimi synoi të:

- Identifikojë rastet e gjuhës së urrejtjes dhe diskursit të dëmshëm në mediat tradicionale, portalet online të lajmeve dhe mediat sociale;
- Analizojë trendet dhe narrativat kryesore, duke përfshirë diskursin e dëmshëm politik, etnik, fetar, të bazuar në gjini dhe retorikën kundër gazetarëve;
- Vlerësojë shkallën e ashpërsisë dhe ndikimin e mundshëm të rasteve të dokumentuara;
- Krahasojë modelet e diskursit ndërmjet mediave në gjuhën shqipe dhe atyre në gjuhën serbe;
- Shqyrtojë marrëdhënien ndërmjet diskursit të dëmshëm, polarizimit politik, dezinformimit dhe amplifikimit digjital;
- Ofron rekomandime për gazetarët, mediat, organet rregullatore, organizatat e shoqërisë civile dhe palët e tjera të interesit.

1.3 Fushëveprimi i Monitorimit

Monitorimi mbuloi periudhën mars–maj 2026 dhe përfshiu përmbajtje të publikuara ose të transmetuara në gjuhën shqipe dhe serbe në:

- Programet televizive informative dhe të aktualitetit;
- Portalet online të lajmeve dhe mediat digjitale;
- Platformat e mediave sociale, përfshirë Facebook, TikTok, Instagram dhe X.

Gjithsej u dokumentuan dhe u analizuan 138 raste të gjuhës së urrejtjes dhe diskursit të dëmshëm. Secili rast u klasifikua sipas llojit të tij, platformës ku u publikua, gjuhës, karakteristikave narrative dhe nivelit të ashpërsisë.

Monitorimi shqyrtoi si format e qarta të gjuhës së urrejtjes, ashtu edhe forma më të gjera të komunikimit të dëmshëm, duke përfshirë delegjitimimin, demonizimin, stereotipizimin, narrativat konspirative, mesazhet e bazuara në frikë dhe forma të tjera të diskursit që kontribuojnë në armiqësi, diskriminim ose përçarje shoqërore.

2. Metodologjia

2.1 Korniza e Monitorimit

Ky ushtrim monitorimi u hartua për të identifikuar, dokumentuar, klasifikuar dhe analizuar gjuhën e urrejtjes dhe diskursin e dëmshëm në mjedisin mediatik të Kosovës. Metodologjia u mbështet në qasje të njohura ndërkombëtarisht, përfshirë Planin e Veprimit të Rabatit të Kombeve të Bashkuara dhe kornizën për matjen e intensitetit të gjuhës së urrejtjes të zhvilluar nga Dr. Babak Bahador.

Megjithëse raporti fokusohet në gjuhën e urrejtjes dhe diskursin e dëmshëm, ai ndjek një qasje analitike më të gjerë sesa përkufizimi juridik i parashikuar në nenin 141 të Kodit Penal të Kosovës. Përveç përmbajtjeve që mund të arrijnë pragun ligjor të gjuhës së urrejtjes, monitorimi shqyrtoi forma të dëmshme të komunikimit si delegjitimimi, demonizimi, stereotipizimi, narrativat konspirative, retorika kundër gazetarëve dhe narrativa të tjera që kontribuojnë në armiqësi, diskriminim ose polarizim shoqëror.

Qëllimi i kësaj qasjeje më të gjerë është parandalimi i dëmit dhe jo ndëshkimi i tij. Ajo bazohet në parimin se diskursi i dëmshëm ekziston në një spektër të gjerë dhe mund të ndikojë negativisht në debatin publik, lirinë e medias dhe kohezionin shoqëror, edhe kur nuk përbën shkelje të ligjit.

2.2 Korniza Ligjore dhe Institucionale

Reagimi i Kosovës ndaj gjuhës së urrejtjes dhe diskursit të dëmshëm mbështetet në disa mekanizma ligjorë dhe institucionalë. Neni 141 i Kodit Penal kriminalizon nxitjen publike të urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit ndaj grupeve të mbrojtura, kur një sjellje e tillë ka gjasa të cenojë rendin publik.

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) rregullon shërbimet mediatike audiovizive, ndërsa Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK) promovon standardet etike përmes vetërregullimit të mediave. Institucioni i Avokatit të Popullit trajton çështjet që lidhen me diskriminimin dhe të drejtat e njeriut, ndërsa Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) koordinon politikat që lidhen me barazinë, përfshirjen dhe mosdiskriminimin. Së bashku, këto institucione luajnë role plotësuese në promovimin e komunikimit publik të përgjegjshëm.



2.3 Fushëveprimi i Monitorimit dhe Mbledhja e të Dhënave

Monitorimi mbuloi periudhën mars–maj 2026 dhe përfshiu përmbajtje publikisht të qasshme, të publikuara ose transmetuara në gjuhën shqipe dhe serbe.

Mostra përfshinte:

- Programet televizive informative dhe të aktualitetit, përfshirë debatet politike në oraret kryesore (prime-time);
- Portalet online të lajmeve dhe mediat digjitale;
- Platformat e mediave sociale, përfshirë Facebook, TikTok, Instagram dhe X.

Rastet potenciale u identifikuan përmes monitorimit të rregullt të mediave të përzgjedhura dhe llogarive publike. Çdo rast i dokumentuar u regjistrua në një bazë të dhënash monitorimi, e cila përmbante informacion mbi burimin, gjuhën, platformën, citatin, kontekstin, kategorinë dhe nivelin e ashpërsisë.

Kur ishte e mundur, lidhjet elektronike, pamjet e ekranit (screenshots) ose referencat përkatëse u ruajtën për qëllime verifikimi. Në rastet kur përmbajtja ishte redaktuar, fshirë ose modifikuar më vonë nga autori ose publikuesi fillestar, vlerësimi u bazua në versionin e publikuar dhe të vëzhguar në momentin e monitorimit, ndërsa pamjet e ekranit u ruajtën aty ku ishin të disponueshme.

Rastet më pas u klasifikuan sipas:

- Llojit të diskursit të dëmshëm, duke përfshirë format politike, etnike, fetare, të bazuara në gjini, kundër gazetarëve, të lidhura me komunitetin LGBTQI+ ose forma të tjera;
- Platformës, përfshirë mediat transmetuese, mediat online dhe mediat sociale;
- Gjuhës (shqipe ose serbe);
- Nivelit të ashpërsisë.

Baza e të dhënave u përdor më pas për të identifikuar trendet, narrativat dominuese dhe dallimet ndërmjet platformave mediatike dhe komuniteteve gjuhësore.

2.4 Vlerësimi i Ashpërsisë

Secili rast i dokumentuar u vlerësua duke përdorur një shkallë pesënivelëshe të ashpërsisë.

Niveli 1: Gjuhë problematike ose fyese, duke përfshirë fyerjet, talljen dhe stereotipizimin.

Niveli 2: Diskurs armiqësor ose degradues që përfshin stigmatizim ose delegjitimim.

Niveli 3: Narrativa demonizuese ose çnjerëzorezuese që paraqesin individë ose grupe si të rrezikshme apo kërcënuese.

Niveli 4: Nxitje të armiqësisë, diskriminimit ose përjashtimit.

Niveli 5: Nxitje të dhunës.

Burimi: Përshtatur nga korniza për matjen e intensitetit të gjuhës së urrejtjes e zhvilluar nga Babak Bahador dhe nga qasje të tjera ndërkombëtare për monitorimin e gjuhës së urrejtjes.

Vlerësimet e ashpërsisë morën në konsideratë jo vetëm përmbajtjen e vetë rastit, por edhe faktorë kontekstualë si statusi i folësit, shtrirja e audiencës, platforma e komunikimit dhe rrethanat më të gjera shoqërore ose politike.

2.5 Kufizimet

Gjetjet e raportit duhet të interpretohen duke pasur parasysh disa kufizime. Monitorimi u përqendrua në media të përzgjedhura dhe në përmbajtje publikisht të qasshme; rrjedhimisht, ai nuk mund të pasqyrojë të gjithë diskursin e dëmshëm që qarkullon në mjedisin informativ të Kosovës. Dukshmëria e përmbajtjeve në mediat sociale ndikohet nga algoritmet e platformave, ndërsa një pjesë e përmbajtjeve mund të jenë fshirë ose modifikuar pas publikimit.

Për më tepër, megjithëse klasifikimi u bazua në kritere të paracaktuara, vlerësimi i diskursit të dëmshëm përfshin në mënyrë të pashmangshme një shkallë të caktuar gjykimi profesional. Monitorimi u fokusua kryesisht në programet kryesore informative, debatet televizive në oraret kryesore (prime-time), portalet online të lajmeve dhe përmbajtjet publikisht të qasshme në mediat sociale. Si rezultat, format e diskursit të dëmshëm që mund të jenë shfaqur në formate të tjera mediatike — përfshirë emisionet ditore të debatit, programet argëtuese, transmetimet lokale ose grupet private online — mund të mos jenë pasqyruar plotësisht në gjetjet e raportit.

Pavarësisht këtyre kufizimeve, metodologjia ofron një bazë të besueshme për identifikimin e trendeve dhe modeleve kryesore të gjuhës së urrejtjes dhe diskursit të dëmshëm në mjedisin mediatik të Kosovës.

3. Pasqyra e Rasteve të Monitoruara

3.1 Vëllimi i Përgjithshëm i Rasteve të Regjistruara

Gjatë periudhës mars–maj 2026, monitorimi dokumentoi gjithsej 138 raste të gjuhës së urrejtjes dhe diskursit të dëmshëm në mediat tradicionale, portalet online të lajmeve dhe platformat e mediave sociale. Shpërndarja mujore mbeti relativisht e qëndrueshme gjatë gjithë periudhës së monitorimit, duke treguar një prani të vazhdueshme të diskursit të dëmshëm në mjedisin mediatik të Kosovës.

Tabela 1. Numri i rasteve të regjistruara sipas muajve

Treguesi	Mars 2026	Prill 2026	Maj 2026	Total
Numri i rasteve	49	47	42	138

Edhe pse në muajin maj u vërejt një rënie e lehtë e numrit të rasteve, diskursi i dëmshëm mbeti i pranishëm në mënyrë të qëndrueshme gjatë gjithë periudhës së monitorimit.

3.2 Përmbledhja e Rasteve të Monitoruara

Monitorimi identifikoi diskurs të dëmshëm në të gjitha kategoritë mediatike, gjuhët dhe nivelet e ashpërsisë. Portalet online të lajmeve përfaqësonin pjesën më të madhe të rasteve të dokumentuara, të ndjekura nga platformat e mediave sociale dhe mediat transmetuese (broadcast). Shumica e rasteve kishin origjinë nga mediat në gjuhën shqipe, ndërsa mediat në gjuhën serbe përbënin pothuajse një të katërtën e të gjitha incidenteve të dokumentuara.

Diskursi politik dhe ideologjik i dëmshëm ishte dukshëm kategoria më e përhapur, duke përfaqësuar gati tre të katërtat e të gjitha rasteve. Vlerësimi i ashpërsisë tregoi më tej se shumica e incidenteve përfshinin komunikim fyes, armiqësor ose delegjitimues, ndonëse një numër më i vogël rasteve përfshinte forma më serioze të demonizimit, diskriminimit ose nxitjes.

Tabela 2. Përmbledhja e rasteve të monitoruara

Indicator	Result
Platforma mediatike:	Portale online të lajmeve (57), Media sociale (44), Media transmetuese (37)
Gjuha	Shqipe (107), Serbe (31)
Lloji më i përhapur:	Politik/Ideologjik (99)
Lloje të tjera:	Etnik/ndërgrupor (10), Kundër gazetarëve (10), Të tjera (7), Stereotipizim (3), Fetar (2), Gjinor (2)
Nivelet e ashpërsisë:	Niveli 1 (64), Niveli 2 (40), Niveli 3 (28), Niveli 4 (4), Niveli 5 (2)

3.3 Gjetjet Kryesore Kuantitative

Analiza kuantitative nxjerr në pah tre gjetje kryesore. Së pari, diskursi i dëmshëm gjatë periudhës së monitorimit u udhëhoq kryesisht nga armiqësia politike dhe ideologjike, e cila përbënte gati tre të katërtat e të gjitha rasteve të dokumentuara. Së dyti, portalet online të lajmeve dhe platformat e mediave sociale shërbyen si kanalet kryesore për shpërndarjen dhe amplifikimin e narrativave të dëmshme. Së treti, ndonëse format etnike, fetare, të bazuara në gjini dhe kundër gazetarëve u shfaqën më rrallë, ato mbeten fusha me rëndësi të veçantë për shkak të ndikimit të tyre të mundshëm në lirinë e medias, kohezionin shoqëror dhe grupet e cenueshme.

Në përgjithësi, gjetjet sugjerojnë se diskursi i dëmshëm në Kosovë është më shumë i formësuar nga polarizimi politik dhe debati publik armiqësor sesa nga format tradicionale të gjuhës së urrejtjes të bazuara në identitet. Në të njëjtën kohë, prania e vazhdueshme e rasteve me ashpërsi më të lartë tregon nevojën për monitorim të vazhdueshëm dhe përpjekje të koordinuara për të promovuar komunikim publik të përgjegjshëm.

4. Trendet dhe Modelet Kryesore

4.1 Gjuha e Urrejtjes Politike dhe Ideologjike dhe Narrativat e Delegjitimimit

Armiqësia politike dhe ideologjike përbënte formën dominuese të diskursit të dëmshëm të identifikuar gjatë periudhës së monitorimit, duke përfaqësuar 99 nga 138 rastet e dokumentuara (71.7%). Gjetjet tregojnë se diskursi i dëmshëm në mjedisin mediatik të Kosovës u udhëhoq kryesisht nga polarizimi politik dhe nga një debat publik gjithnjë e më konfrontues. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre rasteve përfshinte aktorë politikë, zyrtarë publikë, përfaqësues të partive dhe komentatorë që drejtonin retorikë armiqësore ndaj kundërshtarëve politikë, shpesh përmes paraqitjeve mediatike, deklaratave publike dhe platformave të mediave sociale.

Një model i përsëritur konsistonte në delegjitimimin e kundërshtarëve politikë përmes akuzave për tradhti, korrupsion, ndikim të huaj ose mungesë besnikërie. Në vend që të fokusoheshin në dallime programore apo politike, aktorët politikë dhe komentatorët shpesh i paraqisnin kundërshtarët si armiq të interesave kombëtare ose si aktorë që veprojnë kundër shtetit. Shembuj të tillë përfshijnë deklarata si: “Nëse Kurti nuk e demanton, kjo përbën më shumë se tradhti kombëtare” dhe “Kështu Vjosa iu bashkua tavolinës së tradhtisë… po të ishte në Turqi do të pushkatohej.”

Një narrativë tjetër e zakonshme ishte lidhja e kundërshtarëve politikë me Serbinë ose me interesa serbe. Deklarata si “Ju pjella të Serbisë…” dhe referenca ndaj lidhjeve të pretenduara me UDB-në u përdorën për të minuar legjitimitetin dhe patriotizmin e aktorëve politikë duke aktivizuar ndjeshmëri historike dhe kombëtare.

Monitorimi dokumentoi gjithashtu raste të retorikës dehumanizuese dhe kërcënuese. Shembuj përfshinin përshkrime si “kafshë politike” dhe “Eh more qena…”, ndërsa një nga deklaratat më të rënda të regjistruara ishte: “U dashte djali i dëshmorit me dalë me ia ba atij kryt llom.”

Narrativat konspirative shpesh shoqëronin sulmet politike. Zhvillimet politike paraqiteshin si rezultat i planeve të fshehta, manipulimit ose ndikimeve të huaja, në vend të proceseve normale demokratike. Referencat ndaj “skemave” zgjedhore dhe planeve të organizuara kontribuuan në rritjen e mosbesimit dhe në thellimin e polarizimit politik.

Në përgjithësi, diskursi i dëmshëm politik karakterizohej nga delegjitimimi, kornizat konspirative dhe sulmet personale, të cilat shpesh zëvendësonin debatin substancial mbi politikat publike. Gjetjet sugjerojnë më tej se vetë aktorët politikë ishin ndër nxitësit kryesorë të kësaj retorike, duke kontribuar në normalizimin e komunikimit armiqësor dhe polarizues në sferën publike.

Shembull Rasti 1: Kundërshtari Politik i Paraqitur si Tradhtar Kombëtar

Kategoria	Diskurs i dëmshëm politik dhe ideologjik
Data	19 maj 2026
Platforma	Facebook (publikim fillestar), më pas i ripublikuar nga Sinjali dhe portale të tjera online
Folësi	Qytetar (video e publikuar në profil personal në Facebook)
Targeti	Daut Haradinaj, politikan opozitar
Deklarata	“Na paska folur Dauti, Daut Radoiqic. Unë desha t’i them nja dy fjalë Dautit. O Daut, populli të njeh mirë…”

Rëndësia e rastit

Deklarata zëvendëson qëllimisht mbiemrin e politikanit Daut Haradinaj me “Radoiqic”, duke e lidhur atë me Milan Radoiçiq, politikanin dhe biznesmenin serb të lidhur me sulmin në Banjskë të vitit 2023. Përmes kësaj lidhjeje, kundërshtari politik paraqitet si i afërt me një figurë të perceptuar si armiqësore ndaj interesave të Kosovës, duke synuar delegjitimimin dhe stigmatizimin e tij përmes akuzave për mungesë besnikërie dhe tradhti.

Referenca ndaj Kanunit shton gjithashtu një element të nënkuptuar kërcënimi, duke evokuar konceptet tradicionale të ndëshkimit për tradhti. Rasti ilustron gjithashtu mënyrën se si përmbajtja nxitëse e gjeneruar fillimisht në mediat sociale mund të fitojë dukshmëri më të gjerë kur ripublikohet nga portalet online, duke zgjeruar ndjeshëm shtrirjen e saj përtej audiencës fillestare.

4.2 Narrativat Etnike dhe Armiqësia Ndërgrupore

Monitorimi identifikoi 10 raste të armiqësisë etnike dhe ndërgrupore, kryesisht brenda mediave në gjuhën serbe. Ndryshe nga armiqësia politike, e cila targetonte individë, këto narrativa fokusohen tek komunitetet dhe identitetet kolektive.

Një temë e përsëritur ishte paraqitja e institucioneve të Kosovës si vepruese kundër komunitetit serb. Deklarata që i referohen "terrorit kundër serbëve" ("teror nad Srbima"), "persekutimit të popullit serb në Kosovë" ("progon srpskog naroda sa Kosova") dhe "dhunës institucionale kundër serbëve" ("institucionalno nasilje nad Srbima") kornizuan zhvillimet politike dhe institucionale si forma të persekutimit kolektiv.

Disa raste u mbështetën në narrativa të bazuara në frikë që sugjeronin kërcënime ekzistenciale ndaj komunitetit serb. Shembujt përfshinin referenca ndaj "zhdukjes së serbëve nga Kosova" ("istrebljenje Srba sa Kosova") dhe "një llogarie përfundimtare me popullin serb" ("konacni obracun sa srpskim narodom"). Ndërsa fyerjet e drejtpërdrejta etnike ishin relativisht të rralla, narrativat e përsëritura të viktimizimit, pasigurisë dhe kërcënimit kolektiv kontribuuan në mosbesim dhe përforcuan ndarjet ndëretnike.

Gjetjet sugjerojnë se armiqësia etnike u shpreh më pak përmes gjuhës së drejtpërdrejtë të urrejtjes dhe më shumë përmes narrativave të persekutimit, pasigurisë dhe kërcënimit komunitar. Edhe pse më pak e shpeshtë se armiqësia politike, narrativa të tilla mbeten relevante për shkak të ndikimit të tyre të mundshëm në kohezionin shoqëror dhe marrëdhëniet ndëretnike.

Shembull Rasti 2: Veprimet Institucionale të Kornizuara si Persekutim Kolektiv

Kategoria	Narrativa Etnike dhe Viktimizim Kolektiv
Data	25 maj 2026
Platforma	Kosovo Online (portal online i lajmeve)
Folësi	Igor Simic, Srpska Lista
Targeti	Institucionet e Kosovës
Deklarata	"Serbët po vuajnë nga terrori i organizuar institucional." ("Srbi trpe organizovani institucionalni teror.") / "Qëllimi është frikësimi i serbëve para zgjedhjeve." ("Cilj je zastrasivanje Srba pred izbore.")

Rëndësia e rastit

Deklaratat kornizojnë arrestimin e zyrtarëve serbë dhe veprimet e institucioneve të Kosovës jo si masa individuale ligjore apo administrative, por si pjesë e një fushate më të gjerë të drejtuar kundër komunitetit serb në tërësi. Duke i përshkruar veprimet institucionale si "terror i organizuar institucional" dhe duke sugjeruar se qëllimi i tyre është frikësimi i serbëve para zgjedhjeve, retorika përforcon perceptimet e viktimizimit kolektiv dhe pasigurisë etnike. Ky rast ilustron një model të përsëritur të identifikuar në mediat në gjuhën serbe ku zhvillimet politike dhe ligjore interpretohen përmes narrativave të persekutimit, diskriminimit dhe kërcënimit komunitar në vend se përmes proceseve të zakonshme politike ose institucionale.

4.3 Retorika Kundër Gazetarëve dhe Presioni mbi Mediat

Monitorimi dokumentoi 10 raste të retorikës kundër gazetarëve dhe diskursit të dëmshëm të drejtuar ndaj profesionistëve të medias. Edhe pse përfaqësonin një pjesë relativisht të vogël të bazës së përgjithshme të të dhënave, këto raste janë domethënëse për shkak të implikimeve të tyre për lirinë e medias dhe besimin publik në gazetari.

Një model i përsëritur përfshinte paraqitjen e gazetarëve jo si vëzhgues të pavarur, por si aktorë politikisht të lidhur, lobistë, avokatë ose individë që shërbejnë interesa të fshehta. Në vend që t'i përgjigjeshin substancës së raportimit gazetaresk, disa deklarata vinin në dyshim integritetin, motivet dhe pavarësinë e gazetarëve. Në disa raste, gazetarët u përshkruan si "mercenarë", u akuzuan se promovonin narrativa të caktuara në këmbim të përfitimeve financiare, ose u pretendua se ishin të lidhur me rrjete kriminale, politike ose të huaja.

Shembujt përfshinin deklarata nga një figurë politike e cila pretendonte se disa aktorë mediatikë udhëhiqeshin nga axhenda të fshehta dhe interesa financiare. Edhe pse ai nuk identifikoi gazetarë ose media specifike me emër, ai iu referua disa aktorëve mediatikë si "mercenarë" dhe deklaroi: "Mercenarët duhet të deklarojnë pasurinë". Ai pretendoi më tej se disa individë "shumë shpejt japin një shpifje veç pse ju rritet llogaria bankare prej sponsorizuesve" dhe se "ata pa pare s'flasin kurrë". Gjatë të njëjtës diskutim, ai sugjeroi se disa aktorë mediatikë ishin të lidhur ngushtë me interesa kriminale dhe politike, duke pretenduar se ata "kanë pi e kanë hangër bashkë me super-kriminelët për me bo këto fushata".

Edhe pse këto vërejtje u paraqitën si kritikë e përgjithshme ndaj pjesëve të medias dhe jo si akuza të drejtuara ndaj gazetarëve të emëruar, ato i paraqisnin aktorët mediatikë si të motivuar financiarisht dhe të lidhur me interesa të fshehta, në vend se të vepronin në mënyrë të pavarur. Në të njëjtën kohë, ai deklaroi se mbështeste lirinë e shprehjes dhe nuk avokonte mbylljen e mediave.

Monitorimi dokumentoi gjithashtu pretendime se gazetarët ishin të lidhur me interesa të huaja ose merrnin financim të jashtëm. Në një rast, një gazetar pretendoi se individë që punonin si ekspertë dhe gazetarë ishin paguar nga Serbia dhe iu referua një rasti që përfshinte para që pretendohej se kishin origjinë nga agjencia e inteligjencës serbe (BIA). Pretendime të tilla, kur paraqiten pa prova mbështetëse, mund të kontribuojnë në mosbesimin ndaj gazetarëve dhe institucioneve mediatike.

Një rast veçanërisht serioz përfshinte targetimin online të një gazetareje femër përmes publikimit të informacioneve personale dhe mesazheve seksualisht eksplicite. Ky rast ilustron mënyrën se si armiqësia kundër gazetarëve mund të ndërthurret me ngacmimin e bazuar në gjini dhe abuzimin online.

Shumica e rasteve kundër gazetarëve përfshinin delegjitimizim, stigmatizim dhe sulme reputacionale në vend të kërcënimeve të drejtpërdrejta. Megjithatë, përpjekjet e përsëritura për të paraqitur gazetarët si politikisht të kompromet uar, të motivuar financiarisht ose që veprojnë në emër të interesave të fshehta rrezikojnë minimin e besimit publik në gazetarinë e pavarur, inkurajimin e vetëcensurës dhe dobësimin e rolit mbikëqyrës të medias në një shoqëri demokratike.

Shembull Rasti 3: Pretendimet për Financim të Huaj dhe Ndikim në Gazetari

Kategoria	Retorikë kundër gazetarëve dhe delegjitimizim
Data	20 mars 2026
Platforma	Kallxo Përnime (Debat televiziv në kohën kryesore)
Folësi	Gazetar
Targeti	Gazetarë dhe komentatorë mediatikë
Deklarata	Gjatë një debati televiziv, një gazetar iu referua një hetimi të vazhdueshëm penal në Prokurorinë Speciale të Kosovës dhe deklaroi se "ka pasur një operacion në Veri të Mitrovicës ku paret me çanta të strukturave të BIA-së janë zënë duke iu dorëzuar agjentit shqiptar, i cili pastaj ka pas me i qu tek një gazetar".

Rëndësia e rastit

Vërejtjet u diskutuan gjerësisht dhe gjeneruan reagime të konsiderueshme mes gazetarëve, përfaqësuesve të medias dhe aktorëve politikë. Fraza "çanta me para" më pas u shfaq në disa debate publike dhe u përdor për të mbështetur narrativa më të gjera që sugjeronin se disa aktorë mediatikë ishin të ndikuar nga interesat serbe. Edhe pse folësi më vonë tha se vërejtjet e tij ishin keqkuptuar, rasti ilustron mënyrën se si pretendimet që lidhin gazetarët me operacione të ndikimit të huaj mund të bëhen shpejt pjesë e diskursit më të gjerë politik dhe mediatik, duke ndikuar potencialisht besimin publik në gazetari dhe pavarësinë e medias.

4.4 Gjuha e Dëmshme e Bazuar në Gjini, Fetare dhe e Bazuar në Identitet

Monitorimi dokumentoi një numër të kufizuar por të rëndësishëm rastesh që përfshinin diskurs të dëmshëm të bazuar në gjini, fetar dhe të lidhur me identitetin. Edhe pse këto raste përfaqësonin një pjesë relativisht të vogël të bazës së përgjithshme të të dhënave, ato tregojnë se si karakteristikat personale, stereotipet gjinore, përkatësia fetare dhe shënuesit e identitetit mund të përdoren për të diskredituar, tallur ose stigmatizuar individë në debatin publik.

Disa raste targetonin gratë në jetën publike përmes gjuhës gjinore dhe sulmeve të personalizuara. Në vend që të fokusohen në pozicionet politike ose performancën profesionale, politikanet femra iu nënshtruan komenteve që vinin në dyshim kompetencën, identitetin, prejardhjen familjare ose rolin shoqëror të tyre. Në një rast, Ministrja Donika Gërvalla u targetua përmes referencave ndaj familjes dhe babait të saj, duke përfshirë deklaratën: "Shumë kisha pasë qef që kjo (Donika Gërvalla) me e bo ADN-në". Deklarata e zhvendosi diskutimin nga çështjet politike drejt identitetit personal dhe prejardhjes familjare. Në një rast tjetër, ish-Presidentja Vjosa Osmani u quajt në mënyrë talluese "frizerka", një term i përdorur për të zvogëluar pozitën e saj politike përmes stereotipizimit gjinor. Monitorimi dokumentoi gjithashtu sulme online të drejtuara ndaj politikanes Vlora Çitaku, duke përfshirë komente seksiste dhe fyese të qarkullara në mediat sociale.

Monitorimi identifikoi më tej shembuj të gjuhës përçmuese të drejtuar ndaj komuniteteve dhe individëve pakicë. Një politikan iu referua një ish-përfaqësuesi qeveritar të një komuniteti jo-shumicë si "deputeti me ngjyrë", një frazë që rrezikon përforcimin e stereotipeve dhe paragjykimeve ndaj komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptiane.

Identiteti fetar u targetua më rrallë por nuk ishte plotësisht i mungueshëm gjatë periudhës së monitorimit. Një shembull i dukshëm përfshinte një diskutim rreth armëve bërthamore në vendet me shumicë myslimane, gjatë të cilit një i ftuar u përgjigj se vende të tilla duhet të kenë "maksimum deve". Edhe pse u kornizua si koment politik, deklarata mbështetej në një stereotip përçmues që paraqiste shoqëritë myslimane si të rrezikshme dhe inferiore.

Në përgjithësi, këto raste tregojnë se si diskursi i dëmshëm mund të shtrihet përtej rivalitetit politik dhe të targetojë individë ose grupe bazuar në gjini, etnicitet, fe ose identitet personal. Edhe pse më pak i zakonshëm se armiqësia politike, retorika e tillë kontribuon në stigmatizim, përjashtim dhe normalizimin e sëndrimeve diskriminuese në debatin publik.

Shembull Rasti 4: Referencë Përçmuese ndaj një Përfaqësuesi të Komunitetit Pakicë

Kategoria	Stereotipizim dhe Gjuhë Diskriminuese
Data	29 prill 2026
Platforma	Pressing (T7)
Folësi	Bekë Berisha, Deputet i Kuvendit
